



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 13, Datë 26.01.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A. PËR SHTYRJE TË AFATIT TË  
VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“ALBGAZ” SH.A., NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT  
TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 128/1 prot., datë 21.01.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- ERE me vendimin nr. 195, datë 22.09.2021, ka vendosur për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri më datë 20.01.2022. Në kuptim të këtij vendimi shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese, mbi të gjithë dokumentacionin e konstatuar si të munguar në aplikim, me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit sipas kërkesës së shoqërisë.
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., i është drejtuar ERE-s nëpërmjet postës zyrtare elektronike më datë 20.01.2022, duke argumentuar se në kuadër të plotësimit të dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, aktualisht po punon mbi raportin final “WB20-ALB-ENE-01 Albania, Dumrea Underground Natural Gas Storage”, i cili

përmbush kërkesat e paplotësuara për këtë procedurë. Këtë draft-raport shoqëria “ALBGAZ” sh.a. e ka depozituar edhe në ERE. Në këto kushte, shoqëria kërkon mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të vendimarrjes finale për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror të “ALBGAZ” sh.a., deri më datë 20.12.2022.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, në nenin 53, pika 3, citon se: “*Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*”
- Për sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, brenda afatit të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 195, datë 22.09.2021 dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “ALBGAZ” sh.a. për të plotësuar kushtet respektive, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri më datë 20.12.2022.
2. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. duhet të raportojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.01.2022.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**